

TERMA REFERENCE

Ekspert për hartimin dhe konceptimin e skripteve për video, infografe dhe factsheet-e.

Pozicioni/shërbim	Ekspert për skripte (video, infografe, factsheet-e)
Titulli i Projektit	“Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike”
Mbështetur:	Projekti financohet nga Ambasada Britanike në Shqipëri
Lloji i Kontratës :	Kontratë shërbimi – ekspert
Periudha e kontratës	Qershor 2024 – Maj 2025
Ditët e punës	10 ditë pune

Informacion i përgjithshëm për Projektin

Qëllimi kryesor i projektit është të kontribuojë në parandalimin dhe shfaqjen e ndikimeve të panevojshme përmes angazhimit, monitorimit, ngritjes së kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit, si dhe përmes informimit të një grupi të rëndësishëm të aktorëve dhe palëve të interesuara për të siguruar implementimin e drejtë dhe të lirë nga ndikimet e panevojshme në procesin zgjedhor.

Qëllimi i shërbimit

Në kuadër të implementimit të projektit “Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike”, Instituti i Studimeve Politike kërkon një ekspert për hartimin dhe konceptimin e skripteve për video, infografe dhe factsheet-e.

Konkretisht Eksperti duhet të jetë përgjegjës për:

- Konceptimin e ideve dhe hartimin e skripteve **për 6 video** në total;

- Konceptimin e ideve dhe hartimin e scripture për **20 infografikëve** në total;
- Konceptimin e ideve dhe hartimin e scripture për **20 factsheet-e** në total.

	JUNE 2024-DECEMBER 2024							JANUARY 2025 -JUNE 2025				
	2024							2025				
	June	July	Aug	Sep	Oct	Nov	Dec	Jan	Feb	March	April	May
<i>Cost for producing company to produce Awareness Videos (6 videos)</i>	x			x			x		x		x	x
<i>Factsheets on Integrity Standards (20 Factsheets)</i>	xx			xx	xx	xx	xx	xx	xxx		xxx	xx
<i>Infografs "Alert System" on Integrity Standards (20 infographics)</i>	xx			xx	xx	xx	xx	xx	xx		xxxx	xx

Rolet dhe përgjegjësitë që duhet të përmbushin kandidatet:

- Analizimi i qëllimeve dhe objektivave të projektit në funksion të prodhimit të materialeve për vizibilitetin e projektit;
- Skriptimi i videove, infografeve dhe factsheet-eve;
- Redaktimi i përmbajtjes kur materiali bazë vjen nga ekspertët ose stafi i ISP;
- Koordinimi me drejtuesit e projektit, ekspertët ose stafin e ISP , për materialin e brendshëm;
- Bashkëpunimi me subjektet në prodhimin e materialeve të vizibilitetit (videove, infografeve dhe factsheet-eve) duke dhënë idetë e tij dhe duke ofruar mbështetje në prodhimin efektiv multimedial, për t'i bërë ato më tërheqëse për audiencën.

Eksperti duhet gjithashtu:

Të mundësojë dorëzimin e timesheet-eve, duke raportuar mbi orët e shërbimit të realizuara në përputhje me qëllimin e shërbimit të kërkuar, apo çdo dokument shoqërues që do të duhet për raportimin e shërbimit:

- Të jetë disponibël për të përmbushur detyrimet lidhur me shërbimin e kërkuar sipas afatit kohor të përcaktuar;
- Të mbrojë konfidencialitetin e informacionit dhe të dhënave që do mund të merren gjatë ofrimit të

shërbimit.

Profili i ekspertit:

- Diplomuar në nivelin Master Profesional/Shkencor në fushën e Gazetarisë, Komunikimit, Gjuhësisë;
- Përvojë minimumi 5 vite në organizatat e shoqërisë civile;
- Përdorim i shkëlqyer i gjuhës Shqipe;
- Aftësi individuale dhe profesionale;
- Të jetë i/e pavarur dhe i/e paanshëm/e;
- Të gëzojë integritet profesional e moral;
- Të ketë aftësi shumë të mira analitike dhe mendim kritik;
- Të respektojë detyrat dhe afatet e vendosura nga ekipi zbatues i projektit.

Dokumentet e Aplikimit:

Aplikantët e interesuar duhet të dorëzojnë:

1. CV e detajuar;
2. Ofertë Financiare e nënshkruar në GBP.

Aplikimi duhet të dërgohet në një nga 3 variantet, jo më vonë se data 21/06/2024 ora 24:00

1. **Në formë elektronike** në adresën e e-mailit: contactaips@gmail.com ,
2. **Me postë** me zarf të mbyllur titulli i projektit sipër *“ISP_Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike –ekspert për skripte (video, infografe dhe timesheet-e)”,* në adresën: Rr. “Luigj Gurakuqi”, Shk. A, P. 89, K.3, Ap. 16, Tiranë;
3. **Dorazi** me zarf të mbyllur titulli i projektit sipër *“ISP_Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike ekspert për skripte (video, infografe dhe timesheet-e). Të mos hapet përpara datës së tenderit”,* në adresën: Rr. "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P. 89, K.3, Ap. 16, Tiranë.

(Lutemi specifikoni qartë e-mail ose një nr. kontakti.)

Instituti i Studimeve Politike